



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:014550

Datë: 11.05.2018

Numri i dokumentit: 00040422

P. nr.765/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtarja **DIANA SINA**, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit I. K. nga fsh.M. K.Malishevë, për shkak se ka kryer veprën penale, uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme, nga neni 332 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Dep.përgjithshem në Gjakovë, PP.nr.1503/2015 të datës 15.07.2016, në shqyrtimin publik gjyqësor, të mbajtur më datën **07.05.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, të akuzuarit, të dëmtuarit A. K. me Përfaqësuesin e autorizuar F. M., me datën **11.05.2018** mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **I. K.** nga i ati H. dhe e ëma H. e gjinisë G., data e lindjes në fsh.M. K.Malishevë, ku dhe tani banon, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar-atë i 5 fëmijëve, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar ,shtetas i R Kosovës.

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse: Më datë të pavërtetuar e deri me datën 30.10.2015 në fshatin M. Komuna Malishevë në vendin e quajtur “.....”, në mënyrë të kundërligjshëm uzurpon pronën e të dëmtuarit A. K. nga fsh.M. Komuna Malishevë, sipërfaqen prej 88 m2 të ngastrës kadastrale nr. ...e cila është në sipërfaqe të përgjithshme 0.12,47 ha si dhe uzurpon sipërfaqen prej 46 m2 të ngastrës kadastrale e cila është në sipërfaqe të përgjithshme 0.69.35 m2, të cilat sipërfaqe i akuzuari i shfrytëzon duke i punuar dhe duke i marr frutat nga këto pjesë të uzurpuara edhe për kundër vërejtjeve për lirimin e tyre nga ana e të dëmtuarit A. K..

- me çka ka kryer vepër penale, uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme, nga neni 332 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,17 par.1, 41, 49, 50, 51, 73, 332 par.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **5(pesë) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(Një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20,00.-Euro**, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

I dëmtuari A. K. nga fsh.M. K.Malishevë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

DETYROHET i akuzuari I. K., të liroi pronën e paluajtshme të uzurpuar sipërfaqen prej 88 m2 të ngastrës kadastrale nr. ...e cila është në sipërfaqe të përgjithshme 0.12,47 ha si dhe sipërfaqen prej 46 m2 të ngastrës kadastrale e cila është në sipërfaqe të përgjithshme 0.69.35 m2, e ta kthej në posedim të dëmtuarit A. K., nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritë Aktakuzë PP.nr.1503/2015 të datës 15.07.2016, kundër të akuzuarit I. K. nga fsh.M. K.Malishevë, për shkak se ka kryer veprën penale, uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme, nga neni 332 par.1 të KPRK-së dhe ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor, të dënohet sipas Ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.

Prokurori i shtetit Ismet Tofaj në shqyrtimin gjyqësor të dt.28.03.2018,pas dëgjimit të të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit A. K.t e sidomos pas dëgjimit të ekspertit të gjeodezisë M. K. bëri përmisimin e dispozitivit të aktakuzës, ashtu që në rreshtin e tretë pas fjalës Malishevë duhet të jetë “sipërfaqen prej 88 m2 të ngastrës kadastrale nr. ...e cila është në sipërfaqe të përgjithshme 0.12,47 ha si dhe uzurpon sipërfaqen prej 46 m2 të ngastrës kadastrale e cila është në sipërfaqe të përgjithshme 0.69.35 m2, të cilat sipërfaqe i akuzuari i shfrytëzon duke i punuar dhe duke i marr frutat nga këto pjesë të uzurpuara edhe për kundër vërejtjeve për lirimin e tyre nga ana e të dëmtuarit A. K.” ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar.

Përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Prokurori i çështjes gjatë shqyrtimit gjyqësor në fjalën përfundimtare deklaroi, se nga provat e elaboruara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor si dhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit I. K., provat materiale në shkresat e lëndës, certifikatat e pronësisë si në shkresat e lëndës, historiati, aktgjykimi i cili është pjesë e shkresave të lëndës, është vërtetuar mjaftë se i akuzuari sipas aktakuzës PP.nr.1503/15 të dt.15.07.2016 të përmisuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.28.03.2018, është vërtetuar mjaftë se janë plotësuar elementet e veprës penale, por gjykatës i propozoi që me rastin e caktimit të dënimit të ketë parasysh si rrethanë lehtësuese moshën e të akuzuarit, gjendjen e dobët ekonomike si dhe mos dënushmërinë e tij të mëparshme.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit F. M. në fjalën përfundimtare deklaroi, se i bashkëngjitem fjalës përfundimtare të prokurorit të shtetit duke i aprovuar në tërësi aktakuza PP.nr.1503/15 e dt.15.07.2016, duke detyruar të akuzuarin si në pikën II të aktakuzës që ta

liron pronën e uzurpuar dhe në fund të akuzuarin gjykata ta dënoi sipas ligjit në fuqi dhe jemi kundër propozimit të prokurorit të shtetit për rrethanat lehtësuese që i paraqiti para gjykatës lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

I dëmtuari A. K. në fjalën e vetë përfundimtare, deklaroi se i bashkëngjitem fjalës përfundimtare të përfaqësuesit të autorizuar F. M., e vetmja kërkesë e imja është që i akuzuari I. K. ta liron pronën e uzurpuar.

I akuzuari I. K. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se: nuk e ndij veten fajtor pasi që këtë paluajtshmëri në sipërfaqe prej 88 m² nuk e kam uzurpuar por të njëjtën e kam blerë për të cilën jemi marr vesh gojarisht por asgjë nuk kam me shkrim.

Gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike ka dëgjuar të dëmtuarin në cilësinë e dëshmitarit A. K. n, ekspertin e gjeodezisë M. K. në cilësinë e dëshmitarit si dhe ka administruar provat materiale siç janë: certifikatën e njësisë kadastrale komuna Malishevë me nr. ... të dt.06.07.2017, certifikatën e njësisë kadastrale komuna Malishevë me nr.... të dt.06.07.2017, kopjen e planit të lëshuar nga zona kadastrale në Malishevë me dt.25.11.2009, historiatin lidhur me ngastrën kadastrale të lëshuar nga Drejtoria për gjeodezi kadaster dhe pronë Komuna Malishevë me dt.06.07.2016, si dhe foto dokumentacionin të prezentuar nga i akuzuari që bashkëngjiten në shkresat e lëndës.

I dëmtuari në cilësinë e dëshmitarit A. K. gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, deklaroi: se parcela me nr.... me sipërfaqe prej 1247 m² dhe parcelën me nr.... me sipërfaqe prej 2256 m², babai im T. K. i ka shfrytëzuar prej vitit 1976 respektivisht ka punuar tokën dhe i ka marr të mirat bujqësore nga toka, në atë kohë parcela ka qenë në emër I. S. K. të cilin e kemi bashkë fshatar, babai im T. K. nga I. K. ka blerë këto sipërfaqe të tokës për të cilën e kanë lidh edhe kontratën e shitblerjes e pastaj unë me babin tim, vëllezërit e mij kemi shkuar te noteri dhe babai im me vullnetin e tij të lirë e ka kaluar pronën në emrin tim, prandaj kjo pronë nga viti 2013 në bazë të kontratës së shitblerjes dhe në bazë të vullnetit të babait tim dhe vëllezërve të mij ka kaluar në emrin tim dhe këtë e kemi vërtetuar te noteri dhe pastaj njëjta pronësi është regjistruar edhe në kadastrën në Malishevë në emrin tim. Deri në muajin Tetor të vitit 2015 i kam shfrytëzuar unë duke punuar tokën por jo e gjithë sipërfaqen që më takon në bazë të certifikatës së pronësisë, sepse një pjesë të sipërfaqes këtu i akuzuari I. ka vu mexhën dhe nuk më ka lejuar që të shfrytëzoj e gjithë sipërfaqen time të tokës që më takon në bazë të ligjit, në vitin 2016 unë personalisht kam vu shtyllat e betonit në sipërfaqen e tokës aty ku është kontestuese nga i akuzuari I., për arsye se nuk kam deshtë me bërë probleme me I. dhe këtë ia kam lënë Gjykatës në vlerësim, këtë pjesë kontestuese të tokës i akuzuari I. që nga viti 1.... e ka punuar, e ka lëvruar, ka mbjellë tokën dhe ka marr përfitime nga toka. Këto sipërfaqet të përbashkëta që bëhet fjalë i ka punuar vetëm babai im T. K. që nga viti 1976 dhe unë si trashëgimtar i tij kam vazhduar ti punoi, përveç një pjese të këtyre dy parcelave që është kontestuese i shfrytëzon familja e I. K. t, kjo pjesë kontestuese që e shfrytëzon I. është në sipërfaqe prej 88 m² në ngastrën me nr.... dhe në ngastrënjanë 2 m², edhe pse disa herë ia kam tërhequr vërejtjen që ti mos i shfrytëzon këto sipërfaqet të tokës duke ia prezantuar dokumentacionin që kjo sipërfaqe e tokës është në emrin tim, disa herë kam thirr edhe ekspert të gjeodezisë që të vijnë në vendin e ngjarjes por të njëjtit janë penguar nga I. Eksperti i gjeodezisë M. K. ka qenë në vendin e ngjarjes dhe ka bërë matjen dhe konstatimin e gjendjes faktike, i cili edhe e ka bërë ekspertizën në Tetor të vitit 2016 dhe në bazë të kësaj ekspertize Gjykata themelore në Prizren me dt.03.02.2017 ka marr Aktgjykim me nr.C.nr.620/16, me të cilën ka aprovuar si të bazuar kërkesë padinë time dhe babait tim.

Eksperti i gjeodezisë në cilësinë e dëshmitarit M. K., gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, deklaroi, se unë kam bërë ekspertizë me nr.C.nr.620/16 në Tetor të vitit 2016, për këtë çështje juridiko penale më ka angazhuar sipas detyrës zyrtare Gjykata Themelore në Prizren, për të sqaruar një çështje civile në mes të I. K.t dhe A. K.t, kam dalur në vendin e ngjarjes dhe fillimisht kam kryer matjen dhe incizimin e gjendjes faktike në mes të ngastrës, dhe si ngastrat të A. K.t dhe ngastrës pronë e I. K.t, kufiri në mes të ngastrës ... dhe ngastrës ... ndryshon për 88 me² në dëm të ngastrës ... e cila është pronë e A. K.t, pas kryerjes së matjes në teren si dhe shikimin në operatin kadastral në Malishevë që posedon Drejtoria e gjeodezisë në Malishevë, është konstatuar se është bërë ky ndryshim siç cekta më lartë, se nuk ka pasur përputhshmëri ngastra pronë e A. K.t, në bazë të dokumentacioneve kadastrale e cila pas verifikimit dhe matjes në teren ka qenë e zvogëluar prej 88 m², këtë e kam vërtetuar nga dokumentacionet kadastrale dhe me daljen në teren sipërfaqja kontestuese prej 88 m² evidentohet në emër të A. K.t e shfrytëzon I. K., në teren kam vërejt se megja kontestuese ka qenë me disa shtylla e mbështjellur me tela, kush e ka vendosur nuk e di por këtë pronë nuk ka mund ta shfrytëzoi A. K., sa i përket pronës me nr....me daljen në teren dhe me verifikimin e dokumentacioneve kadastrale ka luajtur ndoshta për 1 m² në favor të A. K.t, ndërsa 2 m² në favor të I. K.t, ndërsa ngastra me nr. është e dëmtuar për 46 m² A. K. të cilën pronë e ka shfrytëzuar I. K..

I akuzuari I. K. gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet, në mbrojtje të tij deklaroi se ende këtë pjesë prej 88 m² e mbajë dhe e shfrytëzoi, sepse këtë pjesë të paluajtshme risë kam qenë duke e shfrytëzuar dhe shfrytëzoi që nga viti 1970, pasi që 88 m² e shfrytëzoi unë, është pjesë e arës me nr.... që figuron me sipërfaqe 1247 m², dhe qysh para vitit 1970 kjo ka qenë bashkë me arën që unë e kam blerë që ka evidentuar me numrin dhe ka pas 85 ari, kjo arë atëherë ka pasur çmimin prej 8 mij euro të tanishme, por për këtë pagesë nuk kam dëshmi sepse unë arën e kam blerë duke kompensuar me traktor dhe pajisje tjera të punës e kam blerë nga pronari S. Y. K., këtë marrëveshje e kemi bërë gojore dhe asgjë me shkrim, por këtë e din e tërë fshati, në vitin 1970 kjo arë është ndarë për shkak të ndërtimit të rrugës magjistrale Pejë-Prishtinë prej atëherë ka ndërruar edhe numrin i parcelës nga numri ... ka marr numrin ... që ende është në emër të shitësit S. K., pasi që ende nuk e kam bartur në emrin tim edhe pse nga i njëjti e kam blerë, parcela ... i ka 72 ari kurse parcela me nr.... i ka 1247 m², këtë arë e kam bërë ndërrim me babain e A. K.t në vitin 1973 me kërkesën e tij, edhe pse ara ka qenë në emër të S. K., unë jam pajtuar dhe kam bërë këtë ndërrim me qëllim që të njëjtit të ia mundësoi kalim në rrugën kryesore, kompensim për këtë arë kam marr një arë me nr.716/0 e cila është në emër të vëllaut tim M. K.. Kur kemi bërë ndërrimin e arës ... me T. K. babin e A., jemi pajtuar që kjo pjesë 88 m² të jetë pjesë e imja, ai është pajtuar dhe asnjëherë nuk e ka kërkuar nga unë dhe as nuk e ka punuar kurrë, këtë marrëveshje e kemi bërë gojarisht dhe të njëjtit i kam besuar dhe më ka besuar, edhe vetë i dëmtuarit A. K. vet personalisht e ka bërë rrethojën e sipërfaqes prej 88 m² ashtu siq ka qenë e ndarë gojarisht, i dëmtuari A. K. fshehtazi e ka qitë këtë sipërfaqet në emrin e vet duke e përdorur emrin e I. S. K. të rij trashëguesit i pestë i familjes së I. K. të vjetër.

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka nxjerr të gjitha provat e nevojshme dhe pas administrimit të secilës veç e veç dhe të gjitha së bashku në tërësi ka vërtetuar këtë gjendje faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, andaj në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-ës, për të cilën vepër i akuzuari është penalisht përgjegjës dhe është ndëshkuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, pasi që në rastin konkret gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë e cila kishte për të përjashtuar përgjegjësinë e tij penale.

Pas administrimit të provave pas dëgjimit të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit A. K., Gjykata ka vërtetuar se parcela me nr..... me sipërfaqe prej 1247 m²dhe parcela me nr.....me sipërfaqe prej 2256 m² e ka shfrytëzuar babi i tij T. K. prej vitit 1976,në atë kohë parcela ka qenë në emër të Y. K., pastaj babai i tij T. K. ka blerë këtë paluajtëshmëri nga Y. K. me të cilin ka lidhë edhe kontratë të shitblerjes, e më pastaj babai i tij dhe vëllezërit kanë shkuar te noteri dhe babi i tij me vullnetin e tij të lirë këtë paluajtëshmëri e ka kaluar në emrin e të dëmtuarit A. K.t e pastaj e njëjta pronësi është regjistruar në Kadastër të Malishevës në emrin e të dëmtuarit A. K.. Por i njëjti nuk i ka shfrytëzuar e tërë sipërfaqen e paluajtëshmëris që ka qenë i regjistruar në Kadastër në emrin e tij, nuk i ka shfrytëzuar sipërfaqen prej 88 m² në ngastrën me nr..... dhe 2 m² në ngastrënedhe pse disa herë ia ka tërhequr vërejtjen të akuzuarit I. K.t që ta liron këto pjesë të paluajtëshmëris duke ja prezantuar dokumentacionin por i njëjti ka vazhduar që të shfrytëzon këto parcela edhe pse ka ditë që është në emër të dëmtuarit A. K.t. Këtë e vërteton edhe dëshmia e ekspertit të gjeodezisë i cili ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka dhënë ekspertizën për këtë çështje juridiko penale ,i cili fillimisht ka kryer matjen dhe incizimin e gjendjes faktike ne mes te ngastrësdhe ..., si ngastra ne emër te A. K.dhe ngastrës ... ne emër të I. K. , dhe ka vërtetuar se kufiri ne mes të ngastrës dhe ngastrësndryshon për 88m-katror ,në dëm të ngastrës e cila është pronë në emër e A. K.t , që pas matjes në teren dhe pas shiqimit në operatin kadastral në Malilshve është konstatuar se nuk ka pasur përputhshmëri ngastra ,pronë e A. K.ne bazë te dokumentacioneve kadastrale e cila pas verifikimit dhe matjes ne teren ka qenë e zvogëluar për 88m katror ,në dalje në teren kjo sipërfaqe ka qenë e kufizuar me shtylla të betonit e të mbështjella me tela të cilën nuk ka mundur që ta shfrytëzojë A. K. edhe pse ka qenë në emër të tij .Ndërsa sa i përket ngastrës ...ka luajtur për 1m katror në favor të A. K.t ,ndërsa 2m katror në favor të I. K.t ,ngastra me nr. ka luajtur për 46m katror të cilën pronë e ka shfrytëzuar I. K. e që evidentohet ne emër të A. K.t .Gjykata ka konstatuar se dëshmitë e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit A. K. dhe të ekspertit të gjeodezisë M. K.janë në harmoni me provat materiale të administruara gjate shqyrtimit gjyqësor siç janë :certifikata e njësisë kadastrave komunale ne Malishevë ,me nr. .. dhe ...-...te dt.06.07.2016 ,te cilat parcela janë te evidentuara në emër te dëmtuarit A. K. si dhe janë ne harmoni me histori atin lidhur me ngastrat kadastrave të lëshuara nga Drejtoria për Gjeodezi ,Kadastër dhe Pronë K Malishvë , e dt. 06.07.2016 dhe me fotot që bashkëngjiten në shkresat e lëndës si dhe me kopjen e planit të lëshuar nga Zona Kadastrave Malishevë me dt. 25.11.2009 ,andaj gjykata në bazë te këtyre provave te administruara ka konstatuar se me të vërtetë i akuzuari I. K. ka kryer veprën penale uzurpim i paligjshëm i pronës se paluajtshme nga neni 332/1 të KPRK-së.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar edhe pretendimet e të akuzuarit I. K. i cili nuk e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet me arsyetim se sipërfaqet kontestuese prej 88m katror ende i mban dhe i shfrytëzon sepse këtë e ka shfrytëzuar që nga viti 1970, këtë sipërfaqe e ka blere nga S. Y. K. duke e kompensuar me traktor dhe pajisje tjera të punës ,por për këtë pagës nuk ka dëshmi sepse në atë kohë ka bërë marrëveshje gojore e jo me shkrim ,si dhe thekson se kur ka bërë ndërrimin e arës me nr....me T. K.n babin e A. ,janë pajtuar që kjo sipërfaqe nga 88m katror të jetë pjesë e tij ,këtë marrëveshje e kanë bërë gojarisht ,por A. K. fshehtazi këtë sipërfaqe e ka qitë në emër të tij duke përdor emrin e I. S. K.të ri ,trashëguesit të 5-të të familjes se Y. K. të vjetër .Pretendime e të akuzuarit I. K. janë të pabazuara dhe të paargumentuara me asnjë prove apo dëshmi por gjykata konsideron vetëm përpjekjet e tij për ti ikur përgjegjësisë penale ,sepse me të gjitha provat e administruara e sidomos nga certifikata e Njësisë Kadastrave te Komunës se Malishevas me nr. dhete dt. 06.07.2016 që për gjykatën janë prova të pranueshme pasi janë dhënë nga organet zyrtare te Kosovës ,gjendjen faktike gjykata e ka vërtetuar edhe nga vet deklarata e te akuzuarit I. K. i cili pranon se është duke i shfrytëzuar sipërfaqet kontestuese edhe pse është i vetëdijshëm se këto parcela nuk janë

ne emër të tij por ne emër të dëmtuarit A. K. ,e pastaj gjykata ka ndërlidhur edhe provat tjera me njëra tjetrën dhe ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

Gjatë caktimit dhe matjes së dënimit në kuptim të dispozitës së nenit 73 të KPRK-ës, Gjkata pati parasysh të gjitha rrethanat si ato rënduese, dhe lehtësuese të cilat ndikon në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese Gjkata maur parasysh sjelljet e tij korrekte në Gjykatë, më parë nuk ka ra ndeshë me ligjin, për herë të parë paraqitet në Gjykatë për një veprë të kryer penale, moshën e tij të shtyrë, gjendjen e dobët ekonomike, ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, rrethanat në të cilat është kryer vepra, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjkata të akuzuarit i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej **5(pesë) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në dispozitivin e nenit 41 të KPRK-ës.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës në emër të paushallit gjyqësor është marrë komfor nenit 450 par.2, nën par.2.6 të KPPK-ës.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.765/16 më datë 11.05.2018.**

**Sekretarja juridike,
Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja e vetme gjyqësore
Diana Sina**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:014550
Datë: 18.05.2018
Numri i dokumentit: 00040422